



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
**Opština Orahovac/Municipality Rahovec**  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



## KONTRATË PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

E lidhur në mesë të dy palëve si më poshtë:

1. Komunës në Rahovec të cilën e përsaqëson, z. **Smajl Latifi**, Kryetari i Komunës në Rahovec, (në tekstin e mëtejmë mbështetës financiar), dhe
2. OJQ-së **SHOQATA KULTURORE ARTISTIKE ANADRINI**” person i autorizuar z. Xhafer Bytyqi nga Dejni, Certifikata me numri Fiskal 600875663 dhe me numër të regjistrimit të biznesit 5112671-8, në (tekstin e mëtejshëm përfitues i mjeteve financiare).

**EMRI I PROJEKTIT: PËRGADITJA PËR FESTIVALIN “ANADRINIA JEHON-2018”**

### KUSHTET E KONTRATËS

#### **Neni 1.**

Emri i projektit/programit: PËRGADITJA PËR FESTIVALIN “ANADRINIA JEHON-2018”  
Referenca/ numri i kontratës 15/2018.

Vlera e kontratës në euro: 2000€ (Dymijë euro)

Periudha e zbatimit të projektit nga data 01.03.2018 deri 31.05. 2018

Linja buxhetore, nga kodi i Subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

#### **Neni 2.**

Mjetet nga nen 1 i kësaj kontratë mund të përdoren vetëm për zbatimin e projektit, në përputhje me kushtet e thirrjes publike dhe formës përshkruesc të projektit dhe formularit të buxhetit të projektit, të cilat konsiderohen pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

#### **Neni 3.**

Mjetet nga nen 1 i kësaj kontrate do të paguhen në llogarinë bankare: Nr. Llogarisë bankare 1705001600071856 në Banken NLB .

#### **Neni 4.**

1. Për të kontrolluar përdorimin e duhur të burimeve, përfituesi është i obliguar t'i dorëzojë raport me shkrim ofruesit të mbështetjes financiare për zbatimin e projektit i cili duhet të përfshijë:
  - 1.1 Raportin narrativ (të cilin e dorëzon në formë të shtypur, përmes postës, dhe/ ose në formë elektronike me e-mail apo me post në një CD, DVD ose USB-në, apo në një formë tjeter sipas

kërkesës) i cili duhet të dorëzohet në formë të shkruar (shtypur) dhe përmes postës elektronike në adresë të zyrtarit kompetent.

**1.2** Raporti finansiar i cili dorëzohet nga përfituesi në formë të shkruar dhe postës elektronike duhet të jetë i kompletuar me dokumentacion të detajuar përfshirë të gjithë koston financiare dhe anekset:

- a) Për pagesat e kryera me transaksion bankar: kopjet e faturave, emrin e përfituesit dhe llogarinë bankare përkatëse;
  - b) Për pagesat në para të gatshme: kopjet e faturave emrin e përfituesit, kopje të dëftesës së pagesës nga arka, raportet e parasë së gatshme.
  - c) Dokumentët të tjera: të ndërlidhur me udhëtimin, agjendat dhe të ngjashme, i bashkëngjitni dosjet shoqëruese, dokumentet mbi të cilat pagesat janë kryer si (kontrata, marrëveshjet etj.) dhe të ngjashme.
2. Anekset të tjera lidhur me zbatimin e projektit, dëshmi të implementimit të aktiviteteve të projektit përfshirë (listën e pjesëmarrësve, fletë vlerësimit, fotografi nga ngjarja, kopje të botimeve, etj.).
  3. Përfituesi duhet të dorëzojë raport tremujor/gjysmë-vjetor/raport vjetor/ përfundimtar për zbatimin në afat prej: 15 ditë pas skadimit të periudhës së raportimit, raportet duhet të dorëzohen te financuesi sipas formularëve të paraparë.

#### **Neni 5.**

1. Ofroesi i mbështetjes financiare rezervon të drejtën për monitorimin dhe vlerësimin e ekzekutimit të projektit, duke përfshirë shqyrtimin financiar dhe shpenzimeve të vazhdueshme në çdo kohë gjatë implementimit të projektit dhe për një periudhë prej 1 vit pas përfundimit të projektit.
2. Ofroesi i mbështetjes financiare mund të bëjë drejtpërdrejtë kontrollin e mësipërm të kësaj kontrate përmes një vizite studimore në ambientet e përfituesit por në rast të kontrollit të tillë, përfituesi do të njoftohet të paktën 7 ditë përpara kontrollit nga ofroesi i mbështetjes financiare.

#### **Neni 6.**

Ofroesi i mbështetjes financiare ka të drejtë që për qellim të mbikëqyrjes së përdorimit të fondeve sipas nenit 1 të kësaj kontrate të kontaktoj direkt të gjithë personat juridik dhe fizik të cilët janë paguar nga fondet e projektit, sipas dokumenteve të raportuara nga përfituesi i mbështetjes financiare publike.

#### **Neni 7.**

1. Përfituesi merr përsipër të njoftoj me kohë ofroesin e mbështetjes financiare për ndryshimet e vogla dhe të mëdha në kontratë.
  - 1.1** Ndryshimet e vogla në kontratë që nuk kërkojnë ndryshimin e kontratës përmes shtojcave mund të janë:
    - a) Ndryshime në buxhet në mes të kapitujve të buxhetit, më pak se 10 %
    - b) Ndërrimi i një anëtari te ekipit të projektit
    - c) Ndryshimi i llogarisë bankare të anëtarëve të projektit
    - d) Ndryshimi i adresës ose të dhënave të tjera të projektit
    - e) Ndryshime të vogla në projektet që nuk ndikojnë në qëllimin dhe objektivat (psh. ndryshime të vogla në kohën e aktiviteteve)
  - 1.2** Ndryshimet më të mëdha të kontratës kërkojnë ndryshimin e kontratës përmes një shtojce dhe nënshkrimin e saj nga ofroesi i mbështetjes financiare dhe përfituesi. Ndryshimet më të mëdha në kontratë mund të janë:
    - a) Ndryshimet në buxhet në mes të kapitujve të buxhetit prej më shumë se 10%
    - b) Zgjatjen e kohës së implementimit të projektit (maksimumi 6 muaj)

- c) Shtimi i aktiviteteve të reja në kuadër të projektit
  - d) Ndryshimi i aktiviteteve që në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në qëllimin dhe objektivat e projektit
2. Ofruesi i mbështetjes financiare vendos në çdo rast nëse do të pranoj ndryshimin e kontratës ose jo dhe nëse ndryshimi përbën ndryshim të vogël osc të madh të kontratës

#### **Neni 8.**

1. Përfituesi mund të kërkoj ndryshimet në kontratë të paktën 30 ditë përpëra përfundimit të projektit. Çdo ndryshim në kontratë duhet të kerkohet dhe të miratohet me shkrim. Kontrata nuk mund të ndryshohet ose të plotësohet nëse qëllimi apo efekti i ndryshimit e cenon konkurencën apo trajtimin e barabartë sipas thirrjes publike.
2. Përfituesi nuk mund të kërkoj ndryshimin e dispozitave të kontratës pas përfundimit të periudhës së implementimit të projektit, siç është paraparë në nenin 1 të kësaj kontrate.
3. Ofruesi i mbështetjes financiare publike ka të drejtë të mos e miratojë dhëni e një pjesë të fondeve dhe zgjatjen e periudhës së zbatimit të projektit nëse kjo ndryshon përbajtjen dhe natyrën e projektit, ose në qoftë se kërkesa nuk ka bazë dhe arsyen objektive për ndryshim të kontratës ose zgjatje të periudhës së zbatimit të projektit.
4. Vendimi për miratimin ose mosmiratimin e kërkesës për ndryshim të kontratës apo zgjatje të periudhës së zbatimit të projektit duhet të merret brenda 30 ditësh nga data e kërkesës së përfituesit

#### **Neni 9.**

Nëse ofruesi i mbështetjes financiare përcakton se përfituesi nuk është duke përdorur në mënyrë të papërshtatshme fondet e mbështetjes financiare për implementimin e projektit sipas kushteve të nenit 1 dhe 2 të kësaj kontrate, ose ka dështuar të zbatoj projektin brenda afatit të kontraktuar, në qoftë se nuk ka paraqitur raportet e duhura në kohë dhe me përbajtjen e përcaktuar në nenin 4 të kontratës, ose nuk i ka lejuar ofruesit të mbështetjes financiare mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve sipas nenit 5 dhe 6 të kontratës, pagesat e mëtejshme do të pezullohen, dhe përfituesi është i detyruar të kthej mjetet e shpenzuara në mënyrë të papërshtatshme dhe mjetet ende të pashpenzuara, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim për kthimin e mjetave nga ofruesi i mbështetjes financiare.

#### **Neni 10.**

Nëse ofruesi i mbështetjes financiare përcakton se përfituesi nuk ka përbushur detyrimet kontraktuale, do të mohohet e drejta për të përfituar mbështetje financiare në dy vitet e ardhshme.

#### **Neni 11.**

1. Përfituesi pranon qe në të gjitha materialet e shtypura, video dhe materiale të tjera që lidhen me projektin të vendos logon dhe emrin e ofruesit të mbështetjes financiare si një institucion që financon projektin i cili është objekt i kontratës.
2. Përfituesi pajtohet që ti dorëzoj ofruesit të mbështetjes financiare për përdorim dhe publikim fotot, video dhe të dhëna audio të përmendura në paragrafin 1 të këtij nenit, për të promovuar thirrjen publike dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë civile në Republikën e Kosovës.

#### **Neni 12.**

Ofruesi i mbështetjes financiare nuk është përgjegjës, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, për dëmet e që rrjedhin nga çdo veprimtari e përfituesit në zbatimin e projektit.

#### **Neni 13.**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate përfituesi pajtohet që si përfitues i burimeve publike të financimit për projektet me interes dhe në të mirën e publikut, nuk do të marrin pjesë në promovimin e ndonjë

interesi privat, politik, apo mbështetje për ndonjë parti politike apo kandidat të pavarur gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

#### Neni 14.

Në rast se paraqiten mosmarrëveshje në zbatimin e kësaj kontrate në mes të palëve kontraktuese dhe nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim dhe diskutime të ndërsjella, kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë Gjykata Themelore në Gjakovë.

#### Neni 15.

Për çështjet që nuk janë rregulluar me këtë kontratë, do të vlejnë dispozitat e Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të dhe manuali për zbatimin e saj.

#### Neni 16.

Informacionet që përban forma e përshkrimit të projektit dhe forma e buxhetit të projektit të cilën përfituesi e ka dorëzuar me rastin e aplikimit sipas thirrjes publike janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

#### Neni 17.

Për çdo formë të komunikimit apo dorëzimit të njoftimit për ndryshime në kontratë dhe dorëzimin e raporteve lidhur me këtë kontratë, palët duhet të specifikojnë numrin e referencës së kontratës dhe emrin e projektit dhe të dërgojnë në adresën e mëposhtme.

1. Ardian Rama, Ardian.Rama1@rks-gov.net (për ofruesin e mbështetjes financiare)
2. Xhafer Bytyqi , xhaferbytyqi@hotmail.com (për përfituesin e mbështetjes financiare)

#### Neni 18

Kjo kontratë e nënshkruar nga palët kontraktuese hartohet në 3, (tre) ekzemplar original, ku 1, (një) e marrin përfituesi, ndërsa të tjerët mbesin për nevoja e mbështetësit financier publik.

#### Neni 19.

Kontrata hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të palëve kontraktuese.

*Përmes kësaj kontrate unë i pranoj kushtet e kësaj kontrate dhe solemnisht deklaroj dhe premtoj se do të realizoj me besnikëri, në mënyrë të hapur me ndërgjegje dhe për interes publik mbështetjen financiare nga ofruesi i mbështetjes financiare.*

#### PALET KONTRAKTUESE

Përfituesi i mbështetjes financiare

Përfaqësuesi i autorizuar  
Xhafer Bytyqi

Ofruesi i mbështetjes financiare:

Kryetari i Komunës  
Smajl Latifi

